



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metodologji Mësimdhënies Dhe Mendimi Kritik

Ngarkesa: 8 kredite, 30 seminare, 60 leksione

Viti, semestri kur zhvillohet: Viti I, Sem I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master Shkencor ‘‘ Mësuesi në Gjuhët Angleze’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Metodologjia e Mësimdhënies dhe të menduarit kritik është shqyrtimi dhe studimi i praktikave më të përdorshme dhe të përshtatshme sot në procesin e të nxënësve në të gjitha nivelet dhe llojet e shkollimit, i klasifikimit të karakteristikave të çdo modeli, natyrës, evoluimit dhe zhvillimit të secilit prej tyre, përmes metodave të të nxënësve aktiv, aspekteve psikologjike të zbatuara në mësimdhënie.

Mësimdhënia dhe të menduarit kritik do të ndihmojë studentët në një perceptim më të qartë mbi detyrën e tyre në lehtësimin e të nxënësve të secilit prej nxënësve në klasë. Këto perspektiva teorike për vite me radhë kanë influencuar konceptimin, hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve, shërbimeve dhe politikave arsimore. Lënda ka karakter modular.

Në përfundim të këtij kursi studentët do jenë të aftë të:

- Dallojnë metodat më kryesore të mësimdhënies.
- Klasifikojnë karakteristikat kryesore të metodave të mësimdhënies.
- Evidentojnë rezultatet e studimeve sipas përvojave të ndryshme.
- Zbatojnë modelet moderne të mësimdhënies në sistemin tonë arsimor.
- Gjykojnë në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese. Kuptojnë përkufizimin e të menduarit kritik, rëndësia dhe përkufizimi i termave ‘sistematik’, ‘vlerësim’, ‘formulim’ dhe ‘kritere racionale’.
- Kuptojnë se si lidhet të menduarit kritik me logjikën, vërtetësinë apo pavërtetësinë e thëniesve, dijet dhe fuqizimin personal.
- Krijojnë vetëdijen se ekzistojnë metoda (1) për të kapur gabimet në mënyrën tonë të të menduarit, (2) për të kontrolluar qëndrimet dhe ndjenjat që mund të shtrembërojnë arsyetimin tonë dhe (3) për të arritur një nivel objektiviteti, i cili mundëson